

Dokument politikash: nga Dialogu në Veprim

Ky dokument mbështetet në diskutimet dhe rekomandimet e dala nga Konferenca *Diaspora Flet*, e mbajtur në Këln të Gjermanisë, më 7–9 nëntor 2025. Me mbështetjen e GIZ-MEG, GERMIN, në bashkëpunim me organizatat e diasporës URACult Këln, ODA Hamburg, OASA Berlin, Dija Mynih dhe HorizontAL Frankfurt, lehtësoi dialogun mbi angazhimin e diasporës, bashkëpunimin institucional dhe rrjetëzimin ndërkombëtar.

Koha është tani

Angazhimi me diasporën nuk ka të bëjë më vetëm me lidhjen simbolike. Për Shqipërinë dhe Kosovën, ai tashmë ndodhet në ndërthurjen e zhvillimit ekonomik, arsimin, kulturës, diplomacisë publike dhe shkëmbimit të dijes. Sfida e radhës në nivel politikash nuk është nëse diaspora ka rëndësi në parim, por nëse institucionet e vendeve amë mund t'u ofrojnë aktorëve të diasporës një kornizë të qartë dhe të koordinuar partneriti.

Mesazhi politik

Të kalohet nga komunikimi i rastësishëm tek **partneriteti i strukturuar**: të ndërtohet një kornizë institucionale e koordinuar dhe të bashkëpunohet me nisma me strukturë dhe vizion të qartë.

Mesazhet kryesore nga *Diaspora Flet* 2025

- Organizatat e diasporës në Evropë funksionojnë si një ekosistem i përbashkët shqipfolës; komunikimi i ndarë nga Kosova dhe Shqipëria po krijon paqartësi dhe mbivendosje.
- Ekziston një kërkesë e fortë për një kornizë institucionale më koherente: një pikë të qartë reference për skemat e mbështetjes, kriteret e pranueshmërisë, dhe mundësitë e angazhimit.
- Konferenca dëshmoi vlerën e punës përmes organizatave dhe programeve me besueshmëri, kapital besimi dhe kapacitet zbatues të dëshmuar.

Përmasat e mundësisë*

3,500+


PhD dhe PhD kandidatë shqiptarë
në vendet e OECD-së

300+

organizata të diasporës të hartëzuara nga
GERMIN në Evropë dhe Amerikën e Veriut

€1.1bn+ / €1.4bn+

remitencat drejt Shqipërisë dhe
Kosovës (2025)



Tri veprime prioritare për institucionet në Shqipëri dhe Kosovë

Duke u mbështetur në rekomandimet që dolën nga diskutimet në *Diaspora Flet* 2025 në Gjermani, me përfshirjen e organizatave dhe profesionistëve të diasporës, propozojmë sa vijon:

Krijimin e një Qendre të Përbashkët të Burimeve për Diasporën

1

Të krijohet një Qendër e Përbashkët e Burimeve për Diasporën, e përditësuar rregullisht, me informacion të qartë mbi mundësitë për angazhim, partneritete, mbështetje dhe pikat institucionale të kontaktit në Shqipëri dhe Kosovë. Të përdoret kjo qendër si pikë qendrore reference për të përmirësuar qasjen në informacion, për të ulur fragmentimin dhe për të forcuar komunikimin institucional me të gjithë aktorët e diasporës, përfshirë organizatat, profesionistët dhe shoqatat e biznesit.

Të vlerësohen dhe njihen organizatat e diasporës si partnerë strategjikë

2

Të vendosen instrumente transparente dhe krijohen procese që përfshijnë organizatat e diasporës në konsultim, komunikim dhe hartim programesh që nga fazat e hershme. Të angazhohen organizatat e diasporës mbi bazën e relevancës, qeverisjes dhe historikut të tyre. Të bashkë-kurohen ngjarjet, konferencat dhe nismat për diasporës me partnerët e diasporës për të rritur legjitimitetin, pjesëmarrjen dhe vazhdimësinë.

Të hartëzohet ekosistemi i diasporës dhe të krijohet një databazë praktike

3

Të përgatitet një databazë praktike e organizatave të diasporës për të përmirësuar konsultimin, komunikimin institucional dhe orientimin e politikave. Të përdoret si mjet praktik për të identifikuar partnerë të besueshëm, për ta kuptuar më mirë peizazhin organizativ dhe për të zvogëluar fragmentimin në angazhimin me aktorët e diasporës.

Veprime prioritare

Një Qendër e Përbashkët e Burimeve për Diasporën. Partneritet i strukturuar me organizata të diasporës që nga fillimi i proceseve institucionale. Një hartëzim dhe databazë publike e përditësuar e ekosistemit të diasporës për të përmirësuar konsultimin, komunikimin dhe orientimin e politikave.

Përmbledhje

Ky dokument politikash nuk duhet lexuar vetëm si rezultat i një konference, por si një sinjal politik. Mesazhi i tij qendror është i drejtpërdrejtë: angazhimi me diasporën bëhet më efektiv kur institucionet janë të koordinuara, komunikimi është i qartë dhe organizatat e dëshmuara trajtohen si partnerë. GERMIN mbetet plotësisht i përkushtuar për të kontribuar në këtë proces përmes lehtësimit të dialogut, koordinimit dhe angazhimit të vazhdueshëm me institucionet dhe organizatat e diasporës. Diaspora Flet 2025 dëshmoi qartë se ekziston një kërkesë reale nga poshtë për partneritet. Sfidat tani është që ky momentum i krijuar të përkthehet në veprim institucional më koherent, më të qëndrueshëm dhe me ndikim afatgjatë.